

NJOFTIMI PËR NDRYSHIMIN E DOKUMENTAVE TË TENDERIT

1. Emri dhe adresa e Autoritetit/Entit Kontraktor

Emri Drejtoria Rajonale e OSSH Gjirokastrë
Adresa Blv. "18 Shtatori", pallati 6-katësh përballë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Gjirokastrë.
Tel/Faks:
E-mail: Anila.Jaubelli@yahoo.com
Ueb-faqe: www.ossh.al

2. Kontaktet e personit (ave) përgjegjës për prokurimin:

Emri Anila Jaubelli
E-mail Anila.Jaubelli@yahoo.com

3. Lloji i procedurës së prokurimit: E hapur- Punë (mjete elektronike)

4. Lloji i kontratës: Kontrate - Punë

5. Numri i referencës për procedurën: REF-92120-12-26-2023

6. Obiekti i kontratës: "Zgjatim i fiderit OLM 6, 20 kv, N/ST Sarandë 110/20 KV (Lidhia Unazore), zgjatimi i fiderit OLM 5 për furnizimin e zonës Marinë. Ksamil si dhe rikonstrukcion i rrjetit ekzistues 20 KV dhe rrjetit TU, 0.4 Kv, fideri OLM 5 (Ksamil), N/St. Sarandë 110/20 kv".

7. Kodi sipas Fjalorit të Përbashkët të Prokurimit (FPP): 31321000-2 - Linja të energjisë elektrike

8. Fondi limit: 100,294,255.54 (njëqind milion e dyqind e nëntëdhjetë e katër mijë e dyqind e pesëdhjetë e pesë pikë pesëdhjetë e katër) **lekë pa TVSH.**

9. Justifikimi, argumentat përkatëse dhe referencat ligjore për nevojën e ndryshimit të dokumentave të tenderit:

Në zbatim të nenit 75 të ligjit nr. 162/2020 "Për prokurimin publik", si dhe VKM 285 dt. 19.05.2021 (i ndryshuar) dhe nga asistenca që Agjencia e Prokurimit Publik (APP) i jep autoriteteve/ enteve kontraktore në lidhje me procedurat e prokurimit, sipas emailit të Koordinimit të APP datë 29.12.2023 ora 1:24 PM.

10. Afati i fundit për pranimin e ofertave është: data 15.01.2024, Ora: 11:00/ **Bëhet:23.01.2024 ora 11:00.**

Shënim: Këtij njoftimi duhet t'i bashkëngjitet shtojca e ndryshimeve në dokumentat e tenderit.

SHTOJCE NR.1

PËR MODIFIKIMIN E DOKUMENTAVE TË TENDERIT

Sqarim: Njësia e Prokurimit duke marrë shkak nga asistenca që Agjencia e Prokurimit Publik (APP) i jep autoriteteve/enteve kontraktore në lidhje me procedurat e prokurimit, sipas emailit të Koordinimit të APP datë 29.12.2023 ora 1:24 PM., vendosi të bëjë modifikimet /sqarimet përkatëse në dokumenta tenderi.

Tek shtojcat e specifikimeve teknike ngarkuar në SPE për këtë procedurë prokurimi, kërkohen test raportet nga fabrika sipas kërkesave të parashikuara në material.

Konkretisht për [kabëll bakri 4x10 mm².pdf](#), kërkimi për test raportet është parashikuar në pikën 6. Po ashtu edhe për materialin me emërtesën [koka kabli \(TERMINALE\) TM 20kv.pdf](#), testet janë parashikuar në faqen 3.

Sa i takon periudhës së testimit të këtyre artikujve kohëzgjatja është parashikuar në materialin specifikimet teknike ngarkuar në sistem.

Gjithashtu për çdo specifikim teknik të artikujve në të cilin kërkohet paraqitja e certifikatës së prodhuesit ISO 9001, në rast se OE ofertues nuk është prodhues duhet të paraqes vetëdeklarim që furnizuesi është konform standardeve të cilësisë. AK rezervon të drejtën për verifikimin e vetëdeklarimit në procesin e vlerësimit të dokumentacionit, si dhe në rastin kur OE kualifikohet i pari, AK ka të drejtën të kërkojë paraqitjen e certifikatës të cilësisë të prodhuesit.

Në dokumentat standarte të tenderit, pika 2.3.3 të kapacitetit teknik

Ishte:

2.3.3 Certifikatat e cilësisë që duhet të dorëzojnë operatorët:

- EN-ISO 9001 (Sistemi i menaxhimit të cilësisë) ose ekuivalent
- EN-ISO 14001 (Sistemi i menaxhimit të mjedisit) ose ekuivalent
- BS OHSAS 45001 (Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë) ose ekuivalent

*Te gjitha certifikatat e mesiperme duhet të jene të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues.

*Operatori ekonomik mund të paraqese certifikatat e mesiperme sipas standarteve shqiptare mbi konformitetin e standartit europian dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatat e mesiperme në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Për certifikatën e cilësisë së prodhuesit **ISO 9001**, në rast se OE ofertues nuk është prodhues duhet të paraqes vetëdeklarim që furnizuesi është konform standardeve të cilësisë. AK rezervon të drejtën për verifikimin e vetëdeklarimit në procesin e vlerësimit të dokumentacionit, si dhe në rastin kur OE kualifikohet i pari, AK ka të drejtën të kërkojë paraqitjen e certifikatës të cilësisë të prodhuesit.

Bëhet:

- EN-ISO 9001 (Sistemi i menaxhimit të cilësisë) ose ekuivalent
- EN-ISO 14001 (Sistemi i menaxhimit të mjedisit) ose ekuivalent
- **ISO 45001:2018** (Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë) ose ekuivalent

* Të gjitha certifikatat e mësipërme duhet të jenë të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatat e mesiperme në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Për certifikatën e cilësisë së prodhuesit **ISO 9001**, në rast se OE ofertues nuk është prodhues duhet të paraqes vetëdeklarim që furnizuesi është konform standardeve të cilësisë. AK rezervon të drejtën për verifikimin e vetëdeklarimit në procesin e vlerësimit të dokumentacionit, si dhe në rastin kur OE kualifikohet i pari, AK ka të drejtën të kërkojë paraqitjen e certifikatës të cilësisë të prodhuesit.

Për kriterin e vendosur tek kapaciteti teknik pika 2.3.8, AK sqaron se:

Për kryerjen e këtyre punimeve për këtë investim, operatori ofertues duhet të ketë në stafin e tij të paktën 15 (pesëmbëdhjetë) punonjës elektrikist, të pasqyruar në listepagesat e shoqërisë, me kontratë pune të vlefshme, deshmi profesionale, ku minimalisht **5 (pesë)** prej tyre të jenë të pajisur me kategorinë e IV-t të Sigurimit teknik (të vlefshme).

Kërkesa për 15 specialiste elektriciste, është bazuar në punimet elektrike që do bëhen sipas zërave përkatës të preventivit, të natyrës:

1. Ndërtim linjë e re kabllore me parametra 20 kv;
2. Ndërtim/rikonstrukcion kabinash elektrike TM/TU;
3. Ndërtim linjë e re kabllore ABC TU 0.4 KV;

Përsa i përket kërkesës që *minimumi 5 (pesë) të jenë elektrikistë me grupin e sigurimit teknik IV të vlefshme*, bazuar në këtë rregullore këta persona duhet të jenë më të specializuar në keto drejtime:

-kane aftësi të plotë në organizimin e punimeve në impiantet dhe linjat elektrike .

-njohjen e plotë të skemës së impiantit, të karakteristikave të pajisjeve, të vendosjes së pajisjeve te sektorit te punes se tij

-njohuri te plota mbi rregullat e provave dhe përdorimit të mjeteve mbrojtëse

Në momentin e përfundimit të investimit, pra kur janë shtrire linjat kabllore TU/TM 20 Kv, bëhet vënia në tension pjesë- pjesë nga punonjësi me grupin IV.

Në këtë moment këta punonjës të kësaj kategorie kanë të drejtën e hapjes së dokumentit “Flete-Punimesh”, në të cilën ky punonjës caktohet si udhëzues, mbikqyres për punimet.

Këta punonjës janë të domosdoshëm si drejtues punimesh kur ka linje TM, ndërtim kabinash dhe linje TU për arsye se kur vihet pjesë pjesë në tension hapet dokumenti “Flete-Punimesh”, i cili siglohet nga lejuesi dhe drejtuesi i punimeve.

Afati i fundit për paraqitjen dhe hapjen e ofertave do të jetë data **23.01.2024 , Ora: 11:00.**